REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 113/17
Datë/Datum. 15-05-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWE BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit të Komunës së Prizrenit.
Kopje:	Paneli Shqyrtues- OSHP, Nr. 113/ 17.
Nga:	Samedin GËRXHALIU, Ekspert Teknik Visar BIBAJ, Ekspert Shqyrtues
Lënda:	Ekspertiza për lëndën: " Hartimi i hartës zonale për Komunën e Prizrenit ", me nr. të Prokurimit: 622/ 16/ 109/ 421.
Përgjigjeje në ankesë:	" Plan 2 " SH.P.K. nga Prishtina
Data:	15.05.2017

Bazuar në nenin 114 të LPP-së, Ligjit Nr. 04/ L- 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/ L- 237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L- 068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L- 092, Ju Njoftojmë me Raportin e Ekspertizës, lidhur me Ankesen e parashtruar nga OE " **Plan 2 " SH.P.K.** nga Prishtina, kundër AK- **Komunës së Prizrenit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Hartimi i hartës zonale për Komunën e Prizrenit** " me nr. të Prokurimit: **622/ 16/ 109/ 421**.

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES- TEKNIK

	25.04.2017	**02.05.2017**	**15.05.2017**
Nënshkrimi i ekip.	*Data e autorizimit të eksp.*	*Data e fillimit të ekspertizës*	*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP- Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **18.04.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me **nr. 113/ 17**, e parashtruar nga OE " **Plan 2 " SH.P.K.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin të prokurimit " **Hartimi i hartës zonale për Komunën e Prizrenit** "me nr. të Prokurimit: **622/ 16/ 109/ 421**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- " **Komunës së Prizreni ".**

Konform nenit 113.1, të LPP- ës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK)- **Komuna Prizren.**

N. 111, LPP- Operatori Ekonomik Ankues " Plan 2 " SH.P.K. me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE " **Plan 2 " SH.P.K.** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

1. Neni 1- Qëllimi i LPP-së.
2. Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
3. Neni 13, Paragrafi 1 dhe 2.
4. Neni 20- Klasifikimi i Konkursit të Projektimit sipas Vlerës.
5. Neni 27, Paragrafi 4.
6. Neni 28, Paragrafi 10.
7. Neni 72, Paragrafi 1 dhe 2.
8. Neni 80, Paragrafi 2 dhe 3.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Më datën 31.10.2016 janë shpallur rezultatet e konkursit të projektimit. Fitues është shpallur " Smart Project + UBT + U.T.H. ".
Sipas rezultateve të këtij njoftimi, partneriteti " Plan 2 " SH. P. K. dhe " ABkons " SH. P. K., nuk është eliminuar por metodologjia është vlerësuar, pa të drejt, më së dobëti. Nuk e kemi parë të arsyeshme ankesën përkundër vlerësimit jo të drejtë të një metodologjie ndërkombëtare sepse është vështirë që një aktivitet INTELEKTUAL të merret apo punohet me pa dëshirën e të dy palëve. Edhe mungesa në dokumentet e tenderimit dhe tërë procesin deri te shpallja për herë të parë nuk i kemi marr si të qëllimshme, por më tepër si mungesë eksperience në këtë lloj aktiviteti (Harta Zonale).

I tërë procesi i mëtejmë dëshmon se " lëshimet e rastësishme " në dokumentet e tenderit nuk janë të atilla, ato shndërrohen në vendimtare për shpallje të fituesit?!
Pas shpalljes së anulimit në KRPP të këtij procesi pa asnjë njoftim tjetër në KRPP, i tërë procesi " ngjallet " duke shpallur rezultatet e konkursit të projektimit edhe një herë, dhe në to tani " Plan 2 " SH. P. K., shpallet i papërgjegjshëm?!
Si u " ngjall " ky proces dhe cila është arsyeja e eliminimit nëse vlerësimi i " koncept projektit " ka qenë negativ?!

II) Parregullsitë e procesit të tenderimit:

1. Dosja e tenderit e përgatitur vetëm në një gjuhë (shqipe). Në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/ L- 042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/ L-237, Ligjin 05/ L- 068 dhe Ligjin 05/ L- 092, neni 13.1 dhe 13.2 mungon dosja në gjuhën Serbe dhe Angleze. **Shiko dokumentin nr. 9 të bashkangjitur.**

2. FDT nuk është në përputhje me LPP, neni 27 paragrafi 4 dhe neni 28 paragrafi 10. Kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit duhet të jenë të qarta të formuluara mirë dhe identike në njoftimin për kontratë, sepse:

a) Në nenin 9.1 paragrafi 2 të dosjes së tenderit kërkohen 10 profesionist (vetëm një inxhinier i arkitekturës).

b) Në nenin 9.2 (dëshmit e kërkuara dokumentare) kërkohen dëshmitë për 11 profesionist?! Kërkohen dëshmi edhe për një inxhinier të komunikacionit, e që nuk është në listën e stafit profesional sipas nenit 9.1.

c) Në nenin 17.1 (h)- (dokumentet që përbëjnë dokumentacionin e kandidatit) kërkohen dokumente për 9 ekspert, prej të cilëve dy (2) menaxher të projektit me karakteristika të ndryshme. Tani nuk kërkohet inxhinieri i komunikacionit, juristi dhe inxhinieri i bujqësisë.

d) Në nenin 23.1 janë të shfletuara të gjitha kriteret dhe nën kriteret për vlerësimin e " Koncept Projektit " të cilat nuk janë të njëjta me dosjen e tenderit, respektivisht Aneksi 1 të saj e që tani sipas Ekspertit shqyrtues dhe Panelit po del vendimtar e që donë të thotë nuk pajtohen me kushtet për vlerësim në nenin 23.1 të FDY- ës as në njoftimin për kontratë e as në FDT të dosjes së tenderit.

3. Dokumenti i tenderit sipas kërkesave nuk është as konkurs i pastër i projektimit e as shërbim konsulentë, por një përzierje e të dyjave. Në DT pika 19.2 kërkohet " koncept projekti " me nën kritere ndërsa në Aneks 1 kërkohet metodologjia për vlerësim, definohet minimumi i pikëve për pjesën teknike, të dyja këto sikur për shërbim konsulent, me nën kritere tani plotësisht të ndryshme nga ato në DT pika 23.1. Në DT nën kriteret për vlerësim nuk kanë të bëjnë fare me metodologji të HZ por për projekt- plan arkitektonik që kryesisht korrespondojnë me Konkurs Projektimi nenin 51.19, ndërsa kushtet dhe kërkesat në aneks 1 sikur për shërbim konsulentë nenin 53.15 dhe 53.16 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik. Për këto dokumente për konkurs të projektimit janë shfrytëzuar si mostër dokumentet e Komunës së Ferizajt e që ka qenë njoftim për kontratë për **shërbime**

këshilluese (Konsulencë), për më tepër në aneks 1, 3 dhe 4 në vend të Prizren shkruan FERIZAJ, prandaj, **formularët janë për konkurs të projektimit ndërsa përmbajtja për shërbime këshilluese (Konsulencë). Shiko të bashkangjitur dokumentin nr. 13 njoftimi për kontratë Ferizaj.**

4. Me rezultatet e fundit të konkursit të projektimit, duket e qartë se vlerësimi i " Koncept Projektit " respektivisht metodologjisë është bërë sërish jashtëzakonisht " transparent " duke i ditur paraprakisht autorët dhe të gjitha të dhënat tjera relevante që nuk është dashur të dihen sipas LPP- ës. Vetë rezultatet e shpallura të konkursit të projektimit e tregojnë këtë kur në të parat fituesi i kishte vetëm 82.12 pikë, ndërsa tani një fitues tjetër që sigurisht ka pasur më pak se 82.12 tani shpallet fitues me 93.7 pikë. A nuk e dëshmon kjo shkeljen flagrante të nenit 80 paragrafi 2 dhe 3 të LPP?! Nëse thirremi në nenin 80.2 kushtet në njoftimin për kontratë nuk kanë lidhje me as me Hartë Zonale e as me metodologjinë e kërkuar në aneks 1.

5. Tenderi sipas shifrës i mesëm **(deri në 125,000.00 € sipas nenit 20),** ndërsa sipas vlerësimit të gjithë OE i lartë (të gjitha ofertat me çmime më të larta se sa tenderi me vlerë të mesme). Sipas buxhetit 2016, 2017 dhe parashikimeve për 2018 dhe 2019 Komuna e Prizrenit nuk posedon me mjete për pagesën e çmimit të partneritetit fitues. **Shiko të bashkangjitura buxhetin e Republikë së Kosovës për vitin 2016 dhe 2017 (fletët ku pasqyrohen mjetet me të cilat disponon Komuna e Prizrenit për Harta Zonale).**

III) Vërejtjet në dokumentacionin e Fituesit

Me datën 03.04.2017 në ora 10:00 më është lejuar qasja në dokumente dhe pas kontrollit të dokumenteve të partneritetit të shpallur fitues konstatohet:

a. Juristit të diplomuar të propozuar nga ky partneritet i mungon kontrata e nënshkruar dhe e vulosur e punës.

b. Certifikata e ekspertit për GIS është një certifikatë e vijueshmërisë (vetëm pjesëmarrja) dhe jo e aftësive të arritura?!

c. Në metodologjinë e dorëzuar ju mungon tabela e qartë e ekipit profesional veçmas e përqindjes së angazhimit të tyre e kërkuar në Aneks 1 pika f. Shiko dokumentin nr. 10 të bashkangjitur nga " Plan 2 " SH.P.K., për të parë rëndësinë e tij

Arsyet e eliminimit të " Plan 2 " SH.P.K.

Me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, na njoftoni për eliminimin e partneritetit tonë sepse sikur thoni:

- **OE duhet të ofroj së paku listën e një shërbimi të ngjashëm, të argumentuar me referencë për projektin të cilin e sjellë (e nënshkruar dhe e vulosur) për periudhë nga 01.01.2013 deri më 31.12.2015.**

Në lidhje me pikën e parë nga shërbimet e ngjashme që kemi paraqitur në tender, ju vëmë në dijeni se shërbimet e ngjashme (faqe 43- 136):

1. **Tirana Transport Terminal (Train, Tram and Bus), zhvilluar gjatë periudhës 10.10.2012 deri me 05.09.214 (vërtetuar me faturën e fundit për këtë shërbim)**

Ky shërbim konsiston në detyrat e mëposhtme:

Detyra 1: Rishikimi i studimeve ekzistuese të përgatitura nga Bashkia.
Detyra 2: Vlerësimi i parashikimit të kërkesave.
Detyra 3: Rrjeti i Integrimit, Planifikimi.
Detyra 4: Shërbimeve dhe infrastruktura e nevojshme për terminalin e ri.
Detyra 5: Terminal kryesor dhe shërbimet operative.
Detyra 6: Projeksionet e të ardhurave.
Detyra 7: Ekonomi dhe Financa.
Detyra 8: Analizë Mjedisore dhe Sociale.
Detyra 9: Audit Mjedisor, Shëndetësor dhe i Sigurisë.
Detyra 10: Mjedis dhe Plani i Veprimit Social.
Detyra 11: Struktura e koncesionit.
Detyra 12: Detyrat e Bashkisë.
Detyra 13: Strategjia e Tenderit.
Detyra 14: Identifikimi i rreziqeve.
Detyra 15: Mbledhjet para- tenderimit.
Detyra 16: Gjendja e aseteve në fund të periudhës së koncesionit.
Detyra 17: Përgatitja e dokumentacionit të tenderit dhe kontratës së koncesionit.
Detyra 18: Procesi i tenderit dhe negocimit të kontratës mbështetje.

2. **Plani i Integruar Sektorial (PIS), zhvilluar gjatë periudhës 01.01.2012 deri më 15.08.2013 (vërtetuar me faturën e fundit për këtë shërbim)**

Qëllimi i Planit Sektorial Integruar (PIS) është të përcaktojë zhvillimin e ardhshëm me qëllim të arritjes së një zhvillimi të balancuar dhe të rëndësisë lokale dhe kombëtare dhe të vendosur të përbashkët interesit për një ose më shumë shtetas dhe autoritetet e planifikimit lokal. Këto instrumente janë të dizajnuara për zonat bregdetare, të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe e mjedisit dhe peizazhit, si dhe fusha të tjera me rëndësi të përbashkët apo interesit.
Kjo ISP do të mundësojë Bankers Petroleum dhe Qeveria Shqiptare, duke përfshirë organet e qeverisjes vendore për të përcaktuar zonën e saktë për zhvillimin e ardhshëm të ekuilibruar. Procedura tërë është duke u zhvilluar nga njësitë e qeverisjes vendore, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit përmes pjesëmarrjen e një përfaqësuesi në nënshkrimin e marrëveshjes së Entit të kompetencave të përbashkëta. Pjesë e qëllimit për hartimin e Planit të Integruar Sektorial është edhe ndërmarrja e një Vlerësimin Strategjik Mjedisor për të gjithë ISP. Pas hartimit dhe miratimit të Planit të Integruar Sektorial nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Bankers Petroleum (zhvilluesi) do të jetë në një pozicion për të aplikuar për një leje Infrastrukturës për të gjitha llojet e infrastrukturës publike funksionon si punimet e ndërtimit, rindërtimit dhe/ ose rinovimit i strukturave për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror dhe të transportit të gazit natyror.

3. **Detailing of Student City Campus Master Plan (feasibility study), zhvilluar gjatë periudhës 08.02.2015 deri me 08.04.2015.**

4. **Tirana City Development Strategy zhvilluar gjatë periudhës 31.01.2011 deri më 16.06.2014 (vërtetuar me faturën e fundit për këtë shërbim).**

   - **Një Ekonomist i Diplomuar (kopja e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur) (dëshmi mbi përvojën e punës 3- 5 vite e nënshkruar dhe e vulosur)**

Meqenëse në pjesën me të madhe të Evropës nuk ka fakultete të dedikuara për ekonomist urban, specialiteti ekonomik me i përafërt me këto fushë të re të zhvillimeve të viteve të fundit është ekonomisti agrar i cili në formimin e tij shkollor baza ka shkencat ekonomike në funksion të përdorimit të tokës.
Me rastin ton te ekonomisti Altin MIHALI në CV e tij del e qartë që një pjesë të madhe të eksperiencës së tij profesionale e ka me financat lokale dhe urbane si dhe me pjesëmarrje në rolin e ekonomistit urban dhe ekspertit për buxhetet lokale.
Në lidhje me këtë kërkesë të tenderit kemi propozuar në pozicionin e Ekonomistit Urban z. Altin MIHALI i diplomuar në vitin 1994 në degën Ekonomi Agrare pranë Universitetit të Tiranës me një eksperiencë 23 vjeçare.
Angazhimet:
Viti 2015- Në vazhdim pranë " ALBAKONS " SH.P.K. në rolin e Koordinatorit për tokën shtet dhe të njësive të qeverisjes vendore.
Viti 2008- 2015- Pran Co- Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Institut Kërkimor Shkencor në pozicionin e Ekspertit të Financave Urbane.
Viti 1994- 2007- pran Bashkisë Kuçovë, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit Zhvillimi dhe Marrdhënieve me Jashtë.
Për sa më tepër argumentojmë se z. Altin MIHALI është më se i kualifikuar për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në termat e tenderit.

   - **Njohës i mirë i programit të GIS- it (certifikatë për GIS- ë dhe dëshmi mbi përvojën e punës 6 muaj- 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur)**

Në lidhje me këtë kërkesë të tenderit kemi propozuar në pozicionin e Ekspertit për GIS- ë z. Bexhet ISLAMAJ i diplomuar në vitin 2002 në degën Informatikë pran Universitetit të Tiranës me një eksperiencë 15 vjeçare.
Angazhimet:
Viti 2013- Në vazhdim pranë " ALBAKONS " SH.P.K. në rolin e GIS Manager.
Viti 2011- 2013 pran Lorenco & Co, GIS & IT Manager.
Viti 2010- 2011 pran BlomInfo, GIS & IT Manager.
Viti 2010 pranë Qendra e transferimit të teknologjive Bujqësore (CATT), Programues dhe Konsulent GIS.
Viti 2006- 2009 pranë Agjencisë së Legarizimit, Urbanizmit dhe Integrimi të Zonave Informale, Shef i sektorit GIS dhe IT.
Viti 2004- 2006 pranë Instituti i Studimit të Tokave, Shef i sektorit GIS dhe IT.
Viti 2002- 2003 pranë Land Use Policies Project 2 (L.U.P.P.2), Financuar nga Bashkimi

Evropian, Ekspert GIS dhe IT.
Viti 2001- 2002 Njësia e menaxhimit të Projektit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (PMU/ IPRS), Ekspert Programues dhe IT. Për sa më mirë argumentojmë se z. Bexhet ISLAMAJ është më se i kualifikuar për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në termat e tenderit, në lidhje me sa më sipër ju kemi vënë në dispozicion diplomën e tij të noterizuar. Nuk kuptojmë Cilat Certifikata Vlejnë më tepër se diplomat e universitetit.

Demi Material

Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prizrenit me rastin e vlerësimit dhe rivlerësimit ka ndikuar negativisht në kredibilitetin e kompanisë tonë, duke u bazuar në faktin se vlerësimin e parë ishim të PËRGJEGJSHËM ndërsa në të dytin JO. Vlerësimet e propozimit teknik në të dy rastet ndryshojnë, sikur të bëhej fjalë për një procese apo dokumente tjera. Kjo ankesë, para se gjithash, është një kurajë (guxim) qytetarë për t'i dhënë një mundësi OSHP-ës që të eliminojë këto padrejtësi dhe trajtime të padrejta përmes shkeljeve flagrante të ligjeve tona. Me besim të plotë në organet tona, ligjet dhe drejtësinë shpresojmë dhe kërkojmë që OSHP- ë të bjerë një vendim meritor (rivlerësim apo anulim) përmes të cilit do të ndërpresë praktika të këtilla dhe të demonstrojë vullnetin për të mos lejuar përsëritje të shkeljeve të këtilla të AK- Komuna e Prizrenit dhe cili do AK tjetër.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	29.08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	konkurs projektimi/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas zgjatjes së afatit,	19.09.2016
Data e hapjes së ofertave sipas procesverbalit, ...	26.09.2016
Data e njoftimit mbi rezultatet e konkursit	31.10.2016
Data e Vendimit PSH Nr. 408/ 16 për anulimin njoftimit	21.12.2016
Data e njoftimit për anulimin e dhënies së kontratës	13.01.2017
Data e njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit	19.01.2017
Data e Vendimit PSH Nr. 27/ 17 për anulimin njoftimit	16.02.2017
Data e njoftimit mbi rezultatet e konkursit	30.03.2017 (në KRPP- ë 03.04.2017)

Kriteret për vlerësim

III.1.1) Kërkesat e pranueshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e përshtatshmërisë të specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP- ës, Neni 65, siç është e cekur në piken (a) deri në pikën (i) do të dorëzohen në formë të Aneksit.
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për piken (j) deri në pikën (q).
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik që propozohet për dhënien e kontratës.

III.1.2 Përshtatshmëria profesionale

Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Regjistrimi i TVSH.
3. Regjistrimi i numrit fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit).
2. Kopja e TVSH- ës.

III.1.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar **N/A**

III.1.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

4. Lista e projekteve për shërbime të ngjashme (2013- 2015).
5. Lista e Stafit profesional.

   1) **Një Inxhinier i ndërtimit- konstruktiv.**
   2) **Një inxhinier i arkitekturës.**
   3) **Një inxhinier i hidroteknikës.**
   4) **Një inxhinier i elektroteknikës.**
   5) **Një Ekonomist i diplomuar.**
   6) **Një gjeodet i licencuar.**
   7) **Një jurist i diplomuar.**
   8) **Njohës i mirë i programit të GIS- it.**
   9) **Një inxhinier i bujqësisë.**
   10) **Ekspert i vlerësimit të mjedisit i licencuar.**

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. OE duhet të ofroj së paku listën e një shërbimi të ngjashëm, të argumentuar me reference për projektin të cilin e sjellë (e nënshkruar dhe e vulosur) për periudhë nga 01.01.2013 deri me 31.12.2015.
2. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të personave që janë drejtpërdrejt përgjegjës për dhënien e shërbimeve këshilluese:
   1) **Një Inxhinier i ndërtimit- konstruktiv (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).**
   2) **Një inxhinier i arkitekturës- (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).**
   3) **Një inxhinier i hidroteknikes (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).**

4) Një inxhinier i elektroteknikës (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
5) Një Ekonomist i diplomuar (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
6) Inxhinier i komunikacionit (trafikut) (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
7) Një gjeodet i licencuar (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
8) Një jurist i diplomuar (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
9) Njohës i mire i programit të GIS-it (çertifikate për GIS dhe dëshmi mbi përvojën e punës).
10) Një inxhinier i bujqësisë (diploma kopje e vërtetuar, kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur)- (dëshmi mbi përvojën e punës së paku 3 vite e nënshkruar dhe e vulosur).
11) Ekspert i vlerësimit të mjedisit i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Licenca origjinale ose kopja e vërtetuar).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Kodi	Tenderuesi	Vendi	Çmimi	Vërejte
1	9019	" SMART PROJEKT " N.P.SH.	Prishtinë	186,000.00€	JO
2	1999	N.T.P. " PRIMA ENGINEERING "	Prishtinë	135,000.00€	JO
3	1669	" DIARKO " SH.P.K.	Prishtinë	145,000.00€	JO
4	1905	" HIDRO ING- DK " SH.P.K.	Prishtinë	158,746.00€	JO
5	2802	" PLAN 2 & ABKONS " SH.P.K.	Prishtinë	78,000.00€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë pesë (5) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është regjistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Komisioni ri vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Zana BELLODA, ing. dip. ark. - Kryetar i komisionit.
- Veron ALIU, ing. dip. ark. - Anëtar i komisionit.
- Gafur DAKAJ, ing. dip. ndërt. - Anëtar i komisionit.

Data e mbarimit të vlerësimit: 15.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:..... ///

Raporti i komisionit ri vlerësues:

Përshtatshmëria Administrative e Tenderëve

Nr.	Kodi	Tenderuesi	Tenderi në përshtatshmëri me kërkesat administrative Po/ Jo
1	9019	" SMART PROJEKT " N.P.SH.	JO
2	1999	N.T.P. " PRIMA ENGINEERING "	JO
3	1669	" DIARKO " SH.P.K.	JO
4	1905	" HIDRO ING- DK " SH.P.K.	JO
5	2802	" PLAN 2 & ABKONS " SH.P.K.	JO

Përshtatshmëria Teknike- Profesionale e Tenderëve

Nr.	Kodi	Tenderuesi	Tenderi në përshtatshmëri me kërkesat teknike-profesionale Po/ Jo
1	9019	" SMART PROJEKT " N.P.SH.	JO
2	1999	N.T.P. " PRIMA ENGINEERING "	PO
3	1669	" DIARKO " SH.P.K.	PO
4	1905	" HIDRO ING- DK " SH.P.K.	JO
5	2802	" PLAN 2 & ABKONS " SH.P.K.	JO

Tenderët e përgjegjshëm

Nr.	Kodi	Tenderuesi	Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm Po/ Jo
1	1999	N.T.P. " PRIMA ENGINEERING "	PO
2	1669	" DIARKO " SH.P.K.	PO

Kriteret, nën- kriteret dhe sistemi i pikëve i cili është përdorur për vlerësim:

1. Propozimi teknik, 70 %.
2. Propozimi financiar, 30 %.

Nr.	Nën kriteret e propozimit teknik	Pesha në %
1	Kriteri hapësinor (30 %), përfshinë: • Konceptin hapësinor të zgjidhjes. • Raporti në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore. • Vlerat urbo arkitektonike nga trashëgimia kulturo historike. • Kualiteti i hapësirës.	30 %

	• Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.	
2	Kriteri programor (30 %), përfshinë: • Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes. • Shfrytëzimi racional i hapësirës. • Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor.	30 %
3	Kriteri ekonomik (15%), përfshinë: • Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar. • Racionaliteti i zgjidhjes. • Mirëmbajtja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e kompleksit.	15 %
4	Kriteri i komunikacionit (10%) • Lëvizja pa pengesa e automjeteve. • Parkimi. • Garazhimi.	10 %
5	Kriteri estetik dhe ekologjik- arkitekturë e qëndrueshme (15%), përfshinë: • Origjinaliteti i zgjidhjes. • Inovacioni dhe vlera estetike. • Zgjidhja konsekuente e tërësisë. • Ruajtja dhe avancimi i hapësirës. • Ruajtja e gjelbërimit ekzistues. • Efiçienca energjetike.	15%
	Totali:	100 %

Nr.	Kodi	Emri i OE	Poenët teknike	Çmimi	Poenët financiare	Totali i poenëve
1	1999	N.T.P. " PRIMA ENGINEERING "	63.70	135,000.00€	30.00	93.70
2	1669	" DIARKO " SH.P.K.	52.50	145,000.00€	27.93	80.43

Analiza dhe konstatimet e ekspertit Shqyrtues - Teknik (N. 306)

Eksperti shqyrtues- teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarim hyrës: Eksperti shqyrtues sqaron se te gjitha pretendimet ankimore janë shqyrtuar- trajtuar nga eksperti teknik, pasi qe i njëjti të gjitha shkresat e lëndës i ka pasur në posedim deri në datën e dorëzimit të këtij raporti.

Sqarime dhe Konstatime:

Autoriteti Kontraktues- " Komuna Prizren ", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar

procedurë të hapur, lloji i kontratës është konkurs projektimi, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: " **Plan 2 " SH.P.K. nga Prishtina**, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, pas ri vlerësimit të ofertave të datës 30.03.2017 publikuar nga KRPP- ëja më 03.04.2017.

Kundër të njëjtit vendim parashtruesi i ankese sipas përshkrimit më datën 04.04.2017, paraqet kërkesë për ri- shqyrtim pran AK – Komuna Prizren, me pretendimet ankimore se nuk është respektuar neni 7 dhe 27, i LPP-se. Kundër të njëjtës kërkese AK, me datën 05.04.2017, nxjerr vendim dhe refuzon kerkesen si te pa bazuar ndersa le ne fuqi njoftimin mbi rezultatet e konkursit të projektimit.

Sqarime dhe Konstatime:

Pretendimet ankimore në përgjithësi kanë të bëjnë me kërkesën mbi aftësitë teknike dhe ose profesionale të parapare në piken 9.1, të FDT-së (kapaciteti teknik dhe profesional pozicioni 1 dhe 2, si dhe pika 17.1 e FDT- së).

Eksperti teknik pas analizimit të pretendimeve ankimore të përfshira në ankesën e OE " **Plan 2 " SH.P.K.**, të njëjtat pretendime i kualifikon si **pjesërisht të bazuara:**

II) Parregullsitë e procesit të tenderimit:

1. **e bazuar**, mungojnë dosjet e tenderit të punuara në gjuhën serbe dhe angleze.
2.
    a. **e bazuar**, kërkohen 10 profesionist.
    b. **e bazuar**, kërkohen 11 profesionist (edhe i komunikacionit).
    c. **pjesërisht e bazuar**, kërkohen tetë (8) ekspert, një (1) inxhinier i arkitekturës i cili duhet të jetë Menaxher i Projektit dhe të ketë minimum 6 vjet përvojë profesionale në arkitekturë, planifikim urban si dhe të paktën 3 referenca për plane urbanistike në të kaluarën.
    e bazuar, nuk kërkohet inxhinieri i komunikacionit, juristi dhe inxhinieri i bujqësisë.
    d. **pjesërisht e bazuar**, kriteret dhe nën kriteret për vlerësim (pesha në %) janë të njëjta në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, ndërsa në njoftimin për rezultatet e konkursit të projektimit dy prej tyre ndryshojnë. **Konstatojë** se për vlerësim janë aplikuar kriteret dhe nën kriteret, konform atyre në njoftim për kontratë të cilat janë të njëjta me ato në dosje të tenderit.
3. **pjesërisht e bazuar**, është konkurs projektimi e jo shërbime këshilluese (konsulentë).
    e bazuar, janë shfrytëzuar si mostër dokumentet e Komunës së Ferizajt.
4. **e pabazuar**, është normale që totali i poenëve të vlerësuar të dhënë në njoftimin mbi rezultatet e konkursit të datës 31.10.2016 dhe totali i poenëve të vlerësuar të dhënë në njoftimin mbi rezultatet e konkursit të datës 30.03.2017 (në KRPP- ë 03.04.2017). Sipas vlerësimit të parë në llogaritje për vlerësimin e poenëve kanë marr pjesë pesë (5) OE si të përgjegjshëm, ndërsa në vlerësimin e dytë në llogaritje për vlerësimin e poenëve kanë marr pjesë dy (2) OE si të përgjegjshëm, andaj edhe vlera e totalit të poenëve ndryshon.
5. **e bazuar**, sipas LPP- ës neni 20, tenderi është me vlerë të madhe.
    e pabazuar, është çështje e AK- ës (Komunës së Prizrenit).

III) Vërejtjet në dokumentacionin e Fituesit

a. **e pabazuar**, nuk mungon kontrata e nënshkruar dhe e vulosur e punës e Juristit të diplomuar z. Burim RRECI.
b. **e pabazuar**, certifikata e ekspertit për GIS- it me numër nr. 1458, vërteton se z. Driton MURIQI ka ndjekur kursin profesional inxhinierik për GIS- is dhe është vlerësuar shumë i mirë.
c. **e bazuar,** në metodologjinë e dorëzuar ju mungon tabela e qartë e ekipit profesional veçmas e përqindjes së angazhimit të tyre e kërkuar në Aneks 1 pika f.

Arsyet e eliminimit të " Plan 2 " SH.P.K.

- **e pabazuar**, OE nuk ka ofruar së paku listën e një shërbimi të ngjashëm, të argumentuar me referencë për projektin të cilin e sjellë (e nënshkruar dhe e vulosur) për periudhë nga 01.01.2013 deri më 31.12.2015.

- **e pabazuar**, OE nuk ka ofruar një ekonomist të diplomuar.
  z. Altin MIHALI, me titull ekonomist agrar, ka diplomuar në Ekonomi Agrare pran Universitetit Bujqësor të Tiranës i cili është ekuivalent me Fakultetin e Agro Biznesit në Republikën e Kosovës.

- **e pabazuar**, OE nuk ka ofruar një njohës të mirë të programit të GIS-it, i cili duhet të ketë diplomë në një nga këto lëmi, si: Gjeografi, Arkitekturë apo Ndërtimtari.
  z. Bexhet ISLAMAJ, është Informatikan i diplomuar në degën e Informatikës në Shkencat Natyrore të Universitetit të Tiranës.

Përfundimisht në mbështetje të asaj që u tha me lartë, propozimi ynë është që ky aktiviteti i prokurimit të anulohet pasi që kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate, rezulton të mos jenë të njëjta- identike siç kërkohet në nenin 27, paragrafi 4, i LPP- ës ku shprehimisht thuhet: "...Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike ". Po ashtu dhe versioni gjuhësorë i aplikuar për ketë aktivitet të prokurimit është aplikuar vetëm në gjuhen shqipe e jo dhe në gjuhët tjera të parapara në nenin 13 të LPP-se në fuqi.

Mendimi i ekspertit teknik:

Ekspertët teknik, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozojne panelit shqyrtues qe aktiviteti i prokurimit me titull: " **Hartimi i hartës zonale për Komunën e Prizrenit** ", me nr. të Prokurimit: **622 16 109 421, i inicuar nga AK – Komuna Prizren, te ANULOHEN, dhe nese AK, ende shpreh interes per te te ri-tenderohet,** ndërsa ankesa e OE " **Plan 2** " **SH.P.K.,** të aprovohet si **pjeserisht e bazuar.**